

RREGULLORE DISIPLINORE TË FHK-së

- DISPOZITA THEMELORE:

Neni 1

Me këtë rregullore mbrohen të drejtat e klubeve, shoqatave, anëtarëve të tyre, punëtorëve sportive dhe organizmave tjera sportin e hendbollit, rregullat e organizatës së hendbollit dhe mbarëvajtja e garave në hendboll, sistemi i garave, rregullsia e regjistrimit të lojtarëve dhe organizatave të hendbollit, obligimet e klubeve dhe individëve ndaj seleksionove të reprezentacionit, obligimet e lojtarëve, punëtorëve sportivë, gjyqtarëve, organizatave themelore të hendbollit, marrëdhëniet në mes tyre dhe prestigji i tyre.

Neni 2

Rregullorja disiplinore e FHK përcakton procedurën dhe masat ndaj të gjithë atyre që cenojnë rregullat e lojës së hendbollit, që shkelin Statutin dhe rregulloret e tjera përkatëse të FHK, si dhe atyre që cenojnë prestigjin e sportit të hendbollit në mënyra të ndryshme, duke nënkuptuar edhe prezantimin në vend dhe jashtë tij.

Neni 3

Qëllimi i ndëshkimit është edukimi i anëtarëve të organizatave të hendbollit (lojtarëve dhe personave të tjerë përgjegjës), në frymën sportive, në forcimin dhe zhvillimin e përgjegjësisë dhe disiplinës së tyre, në zbatimin e drejtë të rregullave të përcaktuara me Aktet Normative të FHK, si dhe në ndikimin për sjellje sportive të simpatizuesve të tyre.

Neni 4

Askush nuk mund të dënohet për veprimtarinë ose lëshimet e tij, p u kryer vepra, dhe e i cili me norma nuk është cilësuar si delikt disiplinor e as që është paraparë mënyra e ndëshkimit për kryerjen e deliktit disiplinor.

Neni 5

Shkeljet disiplinore mund të parashihen me Statutin e FHK, statutet e organizatave të bashkuara të hendbollit të Kosovës, rregullat e FHK, rregulloret e përbashkëta të lidhjeve të hendbollit të Kosovës, si dhe Propozicionet e garave.

Neni 6

Kundërvajtja disiplinore mund të kryhet me veprim, qëllim apo lëshim. Kundërvajtja disiplinore është kryer me lëshim, në qoftë se kundërvajtja nuk e ka kryer veprimin të cilin është dashur ta kryejë. Kundërvajtja disiplinore nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, ndëshkohet konform dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Mosnjohja e dispozitave në të cilat është paraparë përgjegjësia disiplinore nuk e arsyeton dhe nuk e liron askënd, mirëpo organi kompetent që e udhëheq procedurën disiplinore, mund të shqiptojë ndëshkimet më të buta për ata të cilët nuk kanë ditur se një veprim i tillë është i ndaluar.

Neni 8

Kundërvajtja disiplinore në tentim do të ndëshkohet sikur të ishte kryer vetë kundërvajtja disiplinore e paraparë në akte gjegjëse. Për kundërvajtjen disiplinore në tentim, dhe nga ajo nuk është shkaktuar pasoja e dëmshme, kundërvajtësit mund të shqiptohet dënimi më i butë sa kundërvajtja e kryer.

Neni 9

Në qoftë se kundërvajtja disiplinore është shkaktuar me veprimin e më shumë pjesëmarrësve, të gjithë ata do të ndëshkohen si bashkëveprues (bashkëpjesëmarrës). Kush e nxit tjetrin apo e ndihmon të shkaktojë kundërvajtjen disiplinore, do të dënohet sikurse ta kishte kryer vetë kundërvajtjen.

Neni 10

Dispozitat themelore të kësaj rregulloreje do të zbatohen ndaj:

- të gjitha organizatave të hendbollit të bashkuara në FHK (klubeve, shoqatave...),
- të gjithë anëtarëve të organizatave themelore të hendbollit, degëve dhe bashkësive të klubeve të hendbollit.

Pjesa e veçantë dhe vlerësimi i dispozitave të kësaj rregulloreje do të zbatohet ndaj klubeve të cilat garat i zhvillojnë në rangun shtetëror dhe komunal ndër komunal, ndaj klubeve në garat përfundimtare të Kupës së Kosovës, ndaj punëtorëve sportivë të hendbollit, të cilët janë anëtarë të organeve dhe trupave të tjerë të Bordit dhe Kuvendit të FHK, ndaj anëtarëve të organeve që udhëheqin garat, si dhe ndaj gjyqtarëve që bëjnë kundërvajtje gjatë garave të lojës së hendbollit.

Neni 11

Dënimi i plotfuqishëm apo masa e ndërmarrë, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, duhet të ketë efekt veprues në veprimtarinë e anëtarëve të organizatave të hendbollit. Personi i dënuar apo i suspenduar me ndalesë të ushtrimit të të gjitha funksioneve në organizatat e hendbollit, nuk mund të ushtrojë kurrfarë funksioni në asnjë organ të klubit, lidhjeve të hendbollit, Federatës dhe as ta përfaqësojë klubin apo organizatën në gara në vend dhe jashtë tij gjatë kohëzgjatjes së dënimit.

Neni 12

Me rastin e matjes së dënimit për kryerësin e kundërvajtjes disiplinore, do të merren parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese e posaçërisht:

- pesha e kundërvajtjes disiplinore dhe pasojat e saj,
- shkalla e përgjegjësisë së kryerësit të kundërvajtjes disiplinore,
- sjelljet e mëparshme të kryerësit, përkatësisht a është dënuar ai më parë për shkelje të njëjta apo të ngjashme të rregullave disiplinore në lëmin e hendbollit dhe
- sjelljet dhe qëndrimi i të dënuarit para dhe pas shqiptimit të kundërvajtjes.

Duke u bazuar në të gjitha këto fakte bëhet edhe shqiptimi i dënimit.

Neni 13

Kundërvajtjet disiplinore të kryera në recidiv – përsëritje, ndëshkohen më ashpër.

Neni 14

Në qoftë se kryerësi i kundërvajtjes në afat prej dy vjetësh nga vuajtja e dënimit të fundit nuk kryen kundërvajtje disiplinore të re, do të konsiderohet sikur nuk ka qenë fare i dënuar. Përfundime nga paragrafi paraprak bëjnë diskualifikimi i përjetshëm dhe përfundimi nga klubi.

Neni 15

Askush nuk mund të dënohet pa u marrë në pyetje apo pa dhënë deklaratë me shkrim. Nëse kryerësi i kundërvajtjes disiplinore nuk i përgjigjet seancës së marrjes në pyetje, ose nuk jep deklaratë me shkrim pas dy ftesave të organit kompetent, vendimi për dënim mund të bëhet në bazë të argumenteve të mbledhura.

Neni 16

Përshkrimi i Procedura disiplinore konsiderohet me prioritet dhe duhet të përfundojë më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes të fletëparaqitjes.

Neni 17

Vendimet e plotfuqishme për dënimet e shqiptuara, evidencohen në librezat e anëtarësisë (lojtarë, punëtorë sportivë etj.), si dhe në evidencën e organit kompetent të FHK. Vendimet e plotfuqishme për dënimin e organizatave të hendbollit, shpallen publikisht dhe njëherazi evidencohen pranë organit kompetent të FHK-së.

Neni 18

Për kundërvajtje disiplinore mund të shqiptohen këto dënime:

A. INDIVIDËVE – LOJTARËVE, TRAJNERËVE, GJYQTARËVE, PUNËTORËVE SPORTIV...

- I. Vërejtja,
- II. Qortimi,
- III. Ndalesa për të luajtur dhe ushtruar funksionin (gjyqtarët, trajnerët, punëtorët sportivë të hendbollit),
- IV. Përgjashtim nga organizata e hendbollit,
- V. Diskualifikimi i përgjeshëm nga sporti i hendbollit,
- VI. Dënim me të holla për gjyqtarët, trajnerët, punëtorët sportivë të hendbollit dhe personave të punësuar në organizatat e hendbollit.

B. ORGANIZATAVE TË HENDBOLLIT - KLUBEVE, SHOQATAVE, TUBIMEVE

1. Vërejtja,
2. Qortimi,
3. Dënimi me të holla,
4. Ndalesë e zhvillimit të ndeshjeve në terrenin ose vendin - rrethin e caktuar,
5. Ndalesë e lojës për kohë të caktuar në vend dhe jashtë vendit,
6. Dënim me marrjen e pikëve prej 1 - deri në 5 pikë,
7. Kthimi në rang më të ulët të garave,
8. Përgjashtim nga organizata e hendbollit,

Neni 19

Dënimi i ndalesës me lojë për numër të caktuar të ndeshjeve nuk mund të jetë më i madh se 8 ndeshje. Ndalesa e zhvillimit të ndeshjeve në terrenin vendas ose vendin ku u bë kundërvajtja nuk mund të jetë më e vogël se 2 (dy) ndeshje, dhe ma shumë se 1 (një) vjet. Dënimi i ndalesës me lojë për numër të caktuar të ndeshjeve mund të shqiptohet në të gjitha rastet ku është paraparë minimumi i përgjithshëm i dënimit të ndalesës së lojës për kohë të caktuar. Dënimi me të holla mund t'iu shqiptohet personave që ushtrojnë profesionalisht detyra në hendboll dhe organizata të hendbollit, ai nuk mund të jetë më i vogël se 50 € e as më i madh se 200 €, ndërsa për persona të cilët janë në marrëdhënie pune me organizatën e hendbollit 15% nga të ardhurat personale në maksimumin e

periudhës kohore prej 6 muajsh. Në vendimin mbi dënimin përcaktohet afati dhe mënyra e pagesës së dënimit me të holla, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë e as më i gjatë se 30 ditë për organizatat e hendbollit, ndërsa për persona në marrëdhënie pune 6 muaj. Dënimi me të holla mund të shqiptohet si dënim kryesor i parë dhe si dënim plotësues i dorës së dytë.

Neni 20

Mjetet nga dënimet me të holla paguhen në favor të avancimit - përparimit të hendbollit të juniorëve dhe këto:

- dënimet të cilat i shqiptojnë organet disiplinore të FHK-së (Komisioni disiplinor, Komisari garave) shkojnë në fond të FHK-së.

Neni 21

Klubi apo organizata e hendbollit, dënimet me të holla i paguajnë në xhirollogaritë rrjedhëse të FHK-së.

Neni 22

Afati për kryerjen e dënimeve me kusht nuk mund të jetë më i shkurtër se 3 muaj dhe më i gjatë se një vit, me ç' rast dënimi nuk do të ekzekutohet në qoftë se gjatë kësaj periudhe i dënuari nuk do të bëjë asnjë kundërvajtje disiplinore.

Neni 23

Dënimi me kusht do të fuqizohet nëse i dënuari me kusht në afatin për të cilin është shtyrë ekzekutimi i dënimit ka bërë çfarëdo kundërvajtjeje disiplinore.

KUSHTET PËR SHQIPTIMIN E DËNIMIT

Neni 24

Me rastin e shqiptimit të dënimit, organi i disiplinor duhet të ketë parasysh kushtet e parapara me Nenin 12 të kësaj rregulloreje.

Neni 25

Pjesëmarrësi i kundërvajtjes disiplinore, i cili ka qenë i dënuar së paku dy herë dhe i cili tregon afinitet për përsëritjen e kundërvajtjeve disiplinore, mund të dënohet më ashpër nga organi disiplinor, por jo më ashpër se që është paraparë me Nenin 12 të kësaj rregulloreje.

Neni 26

Veçanërisht si raste të rënda të kundërvajtjeve disiplinore për të cilat organet disiplinore mund t'i shqiptojnë kundërvajtësit dënimin më të rëndë, konsiderohen ato kundërvajtje, gjatë kryerjes së të cilave kundërvajtësi ka vepruar me vendosmëri, këmbëngulësi dhe pa arsyeshmëri të veçantë, apo kur kundërvajtja disiplinore ka shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda, apo është kryer nën rrethana veçanërisht të rënda.

Neni 27

Për të gjitha kundërvajtjet disiplinore të shkaktuara nga punëtorët sportivë të hendbollit, si përfaqësues të klubeve dhe organizatave të hendbollit, mund të ndëshkohen vetë klubet dhe organizatat e hendbollit.

PJESA E VEÇANTË KUNDËRVAJTJET E ORGANIZATAVE - KLUBEVE

Neni 28

Ekipi i cili pa arsye nuk paraqitet në ndeshjen e garave të përhershme, ose në garat në të cilat është i obliguar të paraqitet, posaçërisht në garat shtesë (Play-off dhe Play-out) do të dënohet me marrjen prej 1 deri 5 pikëve dhe në disa raste edhe dënimi me të holla në shumë prej 200 €. Ekipi i cili pa arsye tërhiqet nga garat do të dënohet me ndalesë që të paraqitet në gara më së paku një vit. Nëse kjo ndodh gjatë garave shtesë (Play-off apo Play-out), dënimi me pike do të përcjellët në edicionin e ri të garave pra, që do të thotë starton me minus pike.

Neni 29

Ekipi i cili nuk i përmbush obligimet e tij ndaj përfaqësuesve të Kosovës (reprezentacioneve) ose e vështirëson përmbushjen e tyre, duke mos i liruuar lojtarët të paraqitën në tubimet e Përfaqësueses për lojë apo përgatitje, do të dënohet me marrjen e 2 pikëve dhe dënim më të holla në shumë prej 500 €. Tentimi do të ndëshkohet.

Neni 30

Klubi i cili pa arsye e lëshon fushën e lojës dhe në thirrje të gjyqtarëve refuzon ta vazhdojë ndeshjen, do të ndëshkohet me dënim me të holla në shumë prej 200 €. Klubit përveç dënimit të përmendur në paragrafin paraprak, i merret një pikë, ndërsa ndeshja regjistrohet me rezultat zyrtar në dobi të ekipit kundërshtar.

Neni 31

Nëse ekipi në terren sillet në mënyrë josportive, pasojë e së cilës është shkaktimi i incidentit apo ndërprerja e ndeshjes, ajo do të dënohet me marrjen e 2- deri 5 pikëve, kurse në rastet tejet të rënda mund të shqiptohet dënimi më i rëndë - kthimi në rang më të ulët të garave. Nëse ndeshja nuk është vazhduar pas ndërprerjes, përveç dënimeve të cekura në paragrafin paraprak, ekipit shkaktohet do të'i merret 1 pikë dhe ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtar në dobi të ekipit kundërshtar.

Neni 32

Nëse vjenë deri tek sulmi fizikë në gjyqtar, vëzhgues dhe lojtarë kundërshtar nga ana e publikut, ekipi vendas dënohet me ndalesë të zhvillimit prej 2- 5 ndeshje pa prezencën e publikut ose në shumë prej 500 €, ndërsa në rastet më të rënda, me ndalesë të zhvillimit të lojërave prej 2 deri 5 ndeshje në terrenin e vet dhe 500 euro, ose në terrenin e territorit të caktuar. Territori në të cilin mund të zhvillohet ndeshja nuk mund të jetë më afër se së paku 20 km. Me dënim të njëjtë do të ndëshkohet klubi i cili pa arsye heq dorë nga organizimi i garave. Për ndërprerjen e përkohshme të ndeshjes për shkak të organizimit të dobët të saj dhe incidenteve të publikut, do të shqiptohet dënimi në të holla në shumë prej 200 €.

Neni 33

Klubi, organizata ose organi i cili jep ose verifikon të dhëna të pavërteta, do të ndëshkohet me dënim me të holla në shumë prej 200 €. Personi përgjegjës në ekip, organizata ose organe të hendbollit për kundërvajtjen e paragrafit paraprak, do të dënohet me ndalesën e të ushtruarit të të gjitha funksioneve në sportin e hendbollit prej 6 muajve deri në 1 (një) vit. Tentimi do të ndëshkohet.

Neni 34

Klubi i cili radhazi nuk i ka zhvilluar dy ndeshje në garat zyrtare dhe i cili ka qenë i dënuar me ndalesën e zhvillimit të ndeshjeve ose i suspenduar, por që përkundër këtyre fakteve merr pjesë në gara zyrtare do të dënohet me kthim në rang më të ulët të garave dhe dënohet më të holla në shumë prej.

Neni 35

Klubi, organizata apo organi kompetent i hendbollit i cili nuk i përmbush obligimet e parapara ndaj FHK dhe subjekteve të tjera të sportit të hendbollit, do të dënohet me marrjen e 2 pikëve ose dënim me të holla në shumë prej 200 €, ndërsa në rastet më të rënda dhe të përsëritura mund të dënohet me kthim në rang më të ulët të garave. Personi përgjegjës në klub, organ apo në organizatë, do të dënohet me ndalesë të ushtruarit të funksionit në sportin e hendbollit prej 1 (një) deri në 3 (tre) vjet. Organizatat e hendbollit, lidhjet dhe organet e tyre do të dënohen me ndalesë të ushtruarit të punëve dhe të detyrave të tjera në këto organizata, ndërsa anëtarët përgjegjës të tyre do të përjashtohen prej organizatave gjegjëse.

Neni 36

Klubi i cili gjatë një viti garues i humb dy ndeshje me rezultat zyrtar, si pasojë e ndërprerjes apo të mos zhvillimit të ndeshjes automatikisht bie në një rang më të ulët të garave.

Neni 37

Klubi në përbërjen e të cilit paraqitet lojtari i paregjistruar ose i regjistruar në mënyrë jo të rregullt (i suspendua ose nën dënim) edhe përkundër vërejtjeve nga personat zyrtarë të FHK-së ai paraqitet do të dënohet me marrjen e 2 pikëve.

Kundër klubit, në përbërjen e të cilit paraqitet lojtari i klubit tjetër pa pëlqimin e ekipit anëtar i të cilit është, do të shqiptohet dënimi me të holla në shumë prej 200 €.

Neni 38

Klubi i cili paraqitet jashtë vendit (Kosovës) për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare dhe ndeshjeve të tjera pa lejen e organit kompetent dhe i cili nuk i përmbahet rregulloreve ndërkombëtare të sporteve përkatëse, do të dënohet me ndalesën e paraqitjes jashtë Kosovës në kohëzgjatje deri një vit, si dhe dënimi me të holla në shumë prej 500 €.

Neni 39

Klubi, lojtarët, gjyqtarët, vëzhgues-kontrolluesit apo funksionarët e të cilit me qëndrime dhe sjelljet e tyre jashtë vendit, i shkaktojnë dëme autoritetit të vendit (Kosovës), autoritetit të organizatës së hendbollit, autoritetit të FHK dhe autoriteteve të bashkësive të tjera shoqërore-politike, do të dënohet me ndalesë të paraqitjes jashtë vendit në kohëzgjatje deri një vit dhe 200 €. Për rastet tejet të rënda klubi do të dënohet me kthim në rang më të ulët të garave.

Neni 40

Klubi i cili me mito dhe mashtrim anëtarëson lojtarë nga klubet e tjera, me ç'rast shkel parimet e amatorizmit dhe rregulloreve në fuqi, do të dënohet me kthim në rang më të ulët të garave. Tentimi do të ndëshkohet.

Personi përgjegjës i klubit i cili në çfarëdo mënyre është i implikuar në këto punë, do të dënohet me ndalim të ushtrimit të të gjitha funksioneve në sportin e hendbollit prej 1 (një) deri 2 (dy) vjet.

Neni 41

Klubi i cili e ushtron veprimtarinë e vet në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së vendit, dispozitat e Statutit të FHK, dispozitat e Rregulloreve mbi organizimin e garave, dispozitat e Propozicioneve të garave, varësisht nga pesha e kundërvajtjes, do të dënohet me marrjen e 2 pikëve dhe 200 €, me kthim në rang më të ulët të garave ose me përjashtim nga organizata e hendbollit. Personi përgjegjës për kundërvajtje nga paragrafi paraprak do të dënohet me ndalimin e të ushtruarit të të gjitha funksioneve në sportin e hendbollit, në kohëzgjatje prej 1 (një) deri në 3 (tre) vjet.

Neni 42

Klubi i cili shkel dispozitat e Rregullores mbi mbrojtjen shëndetësore të lojtarëve (nuk bën kontrollimin mjekësor të tyre), do të dënohet me dënim me të holla në shumë prej 200 €.

Neni 43

Klubet të cilat më herët kanë arritur marrëveshje për kurdisje të rezultatit të ndeshjeve, do të dënohen me marrjen e së paku 5 pikëve dhe dënim me të holla në shumë prej 1000 €.

Për rastet e rënda dhe të përsëritura, klubet do të dënohen me kthim në rang më të ulët të garave. Ndërsa personat përgjegjës që kanë mundur të dinë, do të dënohen me ndalimin e të ushtruarit të të gjitha funksioneve në sportin e hendbollit, në kohëzgjatje së paku dy vjet. Tentimi i kurdisjes së rezultatit të ndeshjeve do të ndëshkohet.

KUNDËRVAJTJET E INDIVIDËVE

Neni 44

Lojtari i cili pa arsye nuk paraqitet në ndeshje për të cilën është caktuar nga klubi dhe është lojtarë me kontratë, do të dënohet me ndalesë loje në kohëzgjatje deri në 6 muaj nga ekipi. Për këtë duhet të informohet FHK-ja. Tentimi do të ndëshkohet.

Neni 45

Lojtari, trajneri, funksionari apo personi përgjegjës në klub, i cili i bind lojtarët e tjerë që për shkaqe të ndryshme ta lëshojnë terrenin ose pengojnë zhvillimin normal të ndeshjes, dënohet:

Trajneri, funksionari ose personi tjetër përgjegjës, me ndalesë të ushtruarit të gjitha funksioneve në kohëzgjatje më së paku prej 3 muaj dhe dënim me të holla në shumë prej 200 në rastet e përsëritura deri në një 1 vit.

Tentimi do të ndëshkohet.

Neni 46

Lojtari i cili i shkel parimet e akteve normative të klubeve dhe FHK-së duke kushtëzuar zhvillimin e ndeshjes me atë materiale ose të holla jashtë suazave dhe normave të përcaktuara me akte përkatëse, do të dënohet me ndalesë loje në kohëzgjatje prej më së paku 6 muaj. Tentimi do të ndëshkohet.

Neni 47

Lojtari i cili me lojë brutale starton në lojtarin kundërshtar me qëllim të lëndimit ose që të arrijë ta lëndojë atë, dhe kjo konstatohet nga personat zyrtarë të ndeshjes do të dënohet me ndalesë loje në kohëzgjatje prej 1-3 ndeshje dhe dënim më të holla shumë prej 200 €. Tentimi do të ndëshkohet. Në rastet e përsëritura ndëshkimi do të jetë progresiv do të thotë 4-8 ndeshje ndalesë loje dhe dënim më të holla në shumë prej 200 €.

Neni 48

Nëse lojtari, gjyqtari apo personi përgjegjës i hendbollit është shkaktar i ndërprerjes dhe vazhdimit të ndeshjes, do të dënohet me ndalesë loje ose ndalesë ushtrimi në funksionit prej 4 ndeshje deri në 2 vjet dhe dënim më të holla në shumë prej 200 €. Tentimi do të ndëshkohet.

Neni 49

Lojtari i cili tenton, ose fizikisht e sulmon lojtarin kundërshtar, gjyqtarët, personat zyrtarë, spektatorët gjatë zhvillimit të lojës ose pas përfundimit të saj, në terren apo jashtë tij, do të dënohet me ndalesë loje në kohëzgjatje prej së paku 4 ndeshje dhe dënim me holla në shumë prej 200 €, në rastet e përsëritura deri në 2 vjet .

Nëse vërtetohet se lojtari ka pasur për qëllim t'i shkaktojë ose i ka shkaktuar lëndime të rënda kundërshtarit, do të dënohet me ndalesë loje në kohëzgjatje së paku 2 vjet, ndërsa në rastet e jashtëzakonshme të rënda do të dënohet me diskualifikim të përjetshëm. Tentimi do të ndëshkohet. Dispozitat e paragrafëve paraprakë do të aplikohen edhe për të gjithë personat zyrtarë të lojës të cilët tentojnë ose shkaktojnë kundërvajtjen disiplinore për çka do të dënohen me ndalesë të ushtrimit të të gjitha funksioneve në sportin e hendbollit së paku dy vjet e në raste të rënda edhe me përjashtim nga organizata e hendbollit.

Neni 50

Lojtari i cili fizikisht e sulmon gjyqtarin, në fushë apo jashtë saj për shkak të sportit të hendbollit, do të dënohet dhe përjashtohet përjetë nga loja e hendbollit.

Neni 51

Lojtari, trajneri, gjyqtari dhe punëtori i hendbollit, i cili para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes ka sjellje jospportive ndaj shikuesve dhe personave zyrtarë, do të dënohet:

- lojtari me ndalesë loje së paku 3 – 6 ndeshje dhe dënim me të holla në shumë prej 200 €,
- trajneri, punëtori i hendbollit dhe gjyqtari, me ndalesë ushtrimi të funksionit prej 3 – 6 ndeshje dhe dënim me të holla në shumë prej 200 €.

Në rastet e përsëritura do të dënohen në mënyrë progresive

- lojtari me ndalesë loje së paku 6 muaj dhe dënim me të holla në shumë prej 200 €, deri një vjet ,
- trajneri, punëtori i hendbollit dhe gjyqtari, me ndalesë ushtrimi të funksionit prej 6 muajve dhe dënim me të holla në shumë prej 200 € deri në 1 vjet.

Neni 52

Lojtari, trajneri apo punëtori i hendbollit, i cili e ofendon gjyqtarin ose personat zyrtarë, do të dënohet me ndalesë loje, përkatësisht ndalesë të ushtrimit të funksionit prej 2 – 4 ndeshje mos lojë dhe dënim me të holla në shumë prej 200 €.

Në rastet e përsëritura dënimet do të jenë progresive pre 6 muaj dhe dënim me të holla në shumë prej 200 € deri një vjet.

Neni 53

Lojtari i cili e shfrytëzon dokumentacionin e falsifikuar, i cili paraqitet me emër të rrejshëm ose i cili me rastin e regjistrimit jep shënime të rrejshme, përkatësisht paraqitet në ekip para se të fitojë të drejtën e lojës, apo në çfarëdo mënyre bie në lajthitje ekipin ose organin e garave, do të dënohet me ndalesë loje prej 6 muajve dhe dënim me të holla në shumë prej 200 € deri në 1 vit.

Nëse kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen punëtori sportiv i hendbollit, do të dënohet me ndalim të ushtrimit të gjitha funksioneve në sportin e hendbollit, së paku 2 vjet, ndërsa në rastet e rënda me diskualifikim të përgjeshëm.

Neni 54

Nëse lojtari paraqitet për ekipe tjetër pa lejen e klubit të tij për të cilin është i regjistruar do të dënohet me ndalesë loje prej 6 muaj dhe dënim me të holla në shumë prej 200 € deri në një vit.

Neni 55

Lojtari, gjyqtari, trajneri apo punëtori sportiv i hendbollit i cili paraqitet nën dënim apo nën suspendim, dhe i cili ushtron funksione në organizatën e hendbollit do të dënohet me ndalesë loje, përkatësisht me ndalesë të ushtrimit të funksionit në hendboll prej 6 muajve dhe dënim me të holla në shumë prej 200 € deri në 2 vjet.

Neni 56

Lojtari i cili pa arsye nuk paraqitet në ndeshjet e reprezentacionit ose nuk i bashkëngjitet përgatitjeve të reprezentacionit, do të dënohet me ndalesë loje prej 3 muajve dhe dënim me të holla në shumë prej 200 € deri në dy vjet.
Tentimi do të ndëshkohet.

Neni 57

Lojtari, gjyqtari, trajneri apo punëtori sportiv i hendbollit, të cilin organi përkatës e fton për ta marrë në pyetje ose prej të cilit kërkon deklaratë me shkrim e i cili pa arsye nuk i përgjigjet ftesës apo nuk e dërgon deklaratën e kërkuar ose atë e dërgon pas afatit të paraparë, do të dënohet me vërejtje, qortim ose ndalesë loje, përkatësisht ndalesë të ushtrimit të funksionit prej 2 ndeshjeve deri në një vit.

Neni 58

Kush sillet në mënyrë josportive (ofendon, fyen, shan, etj.), ndaj lojtarëve, gjyqtarëve, punëtorëve sportivë të hendbollit, funksionarëve, udhëheqësve të organeve dhe organizatave të hendbollit, para, gjatë dhe pas përfundimit të lojës do të dënohet me vërejtje, qortim ose ndalesë të lojës, dhe dënim holla në shumë prej 200 €, përkatësisht ushtrimit të funksionit në sportin e hendbollit deri në një vit. Nëse lojtarët apo personat e tjerë zyrtarë të klubeve, Federatës, shoqatave të gjyqtarëve, trajnerëve dhe shoqatave të tjera të hendbollit japin deklaratë për shtyp dhe opinion të rrejshme, të paargumentuara, të cilat dëmtojnë autoritetin e Federatës do të dënohen me ndalesë ushtrimi të funksioneve në hendboll prej 3 muaj dhe dënim me të holla në shumë prej 100 €, në raste të rënda deri në 2 vjet.

Neni 59

Nëse lojtari i regjistruar paraqitet jashtë vendit, ose për ndonjë ekip të huaj pa lejen e organizatës përkatëse të hendbollit, do të dënohet me ndalesë loje prej 6 muajve dhe dënim me të holla në shumë prej 200 € deri në një vit.

Neni 60

Lojtari i cili përdor mjete të ndaluara stimulative për shtimin e aftësive fizike, do të dënohet me ndalesë loje prej 3-6 muaj dhe dënim me të holla në shumë prej 100 €. Në raste të rënda dhe të përsëritura më shumë herë, ai do të dënohet me ndalesë loje deri në 2 vjet ose me përjashtim nga organizata e hendbollit. Punëtori sportiv i hendbollit i cili në mënyrë të ndryshme e ka ndihmuar

lojtarin në përdorimin e mjeteve të ndaluara, klubi, me dijen e të cilit lojtari-ret kanë shfrytëzuar mjetet e ndaluara, do të dënohen me ndalim të ushtrimit të funksioneve në sportin e hendbollit deri në 2 vjet, përkatësisht me marrjen e 5 pikëve, e në raste më të rënda dhe të përsëritura, do të dënohen me përjashtim nga organizata e hendbollit, përkatësisht me kthim në rang më të ulët të garave. Tentimi do të ndëshkohet.

Neni 61

Gjyqtari, i cili në kohën e caktuar nuk vjen apo fare nuk vjen për zhvillimin e ndeshjes në të cilën është caktuar, ndërkaq mosardhjen nuk e argumenton në afatin e paraparë nuk e lajmëron organin kompetent i cili do të kishte caktuar çiftin rezervë, do të dënohet me ndalesë referimi në kohëzgjatje prej 2 ndeshjeve deri në 6 muaj dhe dënim me të holla në shumë prej 100 €.

Dënimi i paragrafit paraprak i këtij neni do t'i shqiptohet edhe gjyqtarit, i cili është i pranishëm por pa arsye nuk e referon ndeshjen.

Neni 62

Gjyqtari, kontrolluesi apo vëzhguesi i cili e referon (drejton) ndeshjen e ndaluar nga organi kompetent, apo nuk është i deleguar nga organi gjegjë do të dënohet me ndalesë aktiviteti prej 2 ndeshjeve dhe dënim me të holla në shumë prej 100 €, në rastet e përsëritura deri në një vit.

Neni 63

Gjyqtari, i cili nuk e ka referuar ndeshjen i pajisur me veshje të paraparë për gjyqtar, do të dënohet me dënim me të holla në shumë prej 50 €, në rastet e përsëritura me ndalesë referimi prej 1 muajve deri në një vit.

Neni 64

Gjyqtari, i cili pa arsye dhe kundër procedurës së paraparë e ndërpret ndeshjen, do të dënohet me ndalesë të referimit prej 3 muajve dhe dënim me të holla në shumë prej 200 € deri në 1 vit.

Neni 65

Gjyqtari, i cili gjatë referimit bën shkelje materiale të dispozitave të Rregulloreve të lojës së hendbollit, i cili plotësisht nuk i njeh ato, përkatësisht nuk i njeh dispozitat e Akteve normative në fuqi nga lëmi i sportit të hendbollit, të organeve të cilat i organizojnë garat, do të dënohet me ndalesë referimi prej së paku 4 ndeshjeve deri në 1 vit.

Neni 66

Gjyqtari, i cili para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes, sillet në mënyrë josportive, ose i cili fizikisht e sulmon lojtarin, trajnerin, punëtorin sportiv të hendbollit apo shikuesin, do të dënohet me ndalesë referimi prej 1 - 2 vjet, e në rastet posaçërisht të rënda, me diskualifikim të përjetshëm.

Neni 67

Gjyqtari, kontrolluesi apo vëzhguesi i cili në afatin e caktuar nuk e dorëzon raportin dhe kontrollimin e ndeshjes apo atë nuk e dorëzon në formën e paraparë, do të dënohet me ndalesë referimi dhe delegimi prej 2 ndeshjeve deri në 1 vit dhe dënim me të holla në shumë prej 100 euro.

Neni 68

Gjyqtari, kontrolluesi, vëzhguesi i ndeshjes i cili shpenzimet e referimit i paguan më shumë se është paraparë, do të dënohet me ndalesë referimi, përkatësisht ndalesë të të ushtruarit të funksionit së paku

2 ndeshje dhe dënim me të holla në shumë prej 100 €, e në rastet e rënda edhe me diskualifikim të përjetshëm.

Shpenzimet më tepër të paguara, personat nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të obliguar t'ua kthejnë organizatave të hendbollit nga të cilat i kanë marrë.

Tentimi do të ndëshkohet.

Neni 69

Gjyqtari, kontrolluesi i referimit, vëzhguesi i cili merr mito për obligimet që duhet kryer gjatë referimit e që rrjedhin nga dispozitat përkatëse të lojës së hendbollit, do të dënohet me ndalesë referimi, përkatësisht ndalim të ushtrimit të funksionit së paku 3 muaj e më së shumti 1 vit, e në raste posaçërisht të rënda, me diskualifikim të përjetshëm ose me largim nga organizata e hendbollit.

Neni 70

Gjyqtari ose punëtori sportiv i hendbollit, i cili ushtron detyrën e delegatit-kontrolluesit, i cili nuk paraqet raport apo paraqet raport jo të saktë, duke bërë ndryshime rreth situatave relevante të ndeshjes, do të dënohet me ndalesë referimi, përkatësisht ndalesë të ushtrimit të funksionit në kohëzgjatje prej 2 ndeshjeve dhe dënim më holla në shumë prej 100 €, në rastet e përsëritura deri në 1 vit.

Neni 71

Nëse punëtori sportiv i hendbollit nuk e kryen detyrën për të cilën është caktuar, do të dënohet me ndalim të ushtrimit të funksionit së paku 2 ndeshje dhe dënim me të holla në shumë prej 100€, në rastet e përsëritura deri në 1 vit.

Neni 72

Në qoftë se anëtari i organizatës së hendbollit, kërkon prej anëtarëve të tjerë të organizatës, klubeve, shoqatave të hendbollit, dobi materiale për kryerjen e punëve për të cilat është caktuar, ose ato nuk i kryen edhe pse është i obliguar t'i kryejë, do të dënohet me ndalim të të gjitha funksioneve në sportin e hendbollit së paku 1 vit, e në rastet e përsëritura dhe posaçërisht të rënda, me diskualifikim të përjetshëm dhe përjashtim nga organizata e hendbollit. Nëse kundërvajtjen nga alineja paraprake e ka shkaktuar funksionari apo anëtari i klubit, atëherë klubi do të dënohet me të holla së paku 200 €.

Neni 73

Trajneri apo punëtori sportiv i hendbollit, i cili nën kërcënim e detyron lojtarin të paraqitet, e bie nën dënim, suspendim (pa kontroll mjekësor, me emër të rrejshëm dhe librezë të huaj të anëtarësisë), do të dënohet së paku me një vit ndalesë të të ushtruarit të të gjitha funksioneve në sportin e hendbollit, ose me përjashtim nga organizata e hendbollit.

Neni 74

Gjyqtari i cili referon nën dënim apo suspendim, do të dënohet me ndalesë referimi prej 1 muaj dhe 100 €, në rastet e përsëritura deri në 1 vit.

Me dënimin nga paragrafi paraprak, do të ndëshkohet gjyqtari, i cili jep deklarata të rrejshme për mjetet e informimit lidhur me situatat eaktuara të cilat i përkasin sportit të hendbollit dhe punëtorëve sportivë të tyre.

Neni 75

Punëtori sportiv i hendbollit, gjyqtarët, kontrolluesit e referimit, lojtarët si anëtarë të organizatave të hendbollit, funksionarët, përgjigjen për çdo shkelje të dispozitave të akteve në fuqi, të organizatave drejtuese të hendbollit.

Për shkeljen e dispozitave të përmendura, anëtarë i organizatës së hendbollit do të dënohet me ndalesë loje, përkatësisht ndalesë të ushtruarit të funksionit si vijon:

- për shkak të keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo tejkalimit të autorizimeve, prej 3 muajve deri 1 vit, e në raste posaçërisht të rënda me diskualifikim të përjetshëm dhe përjashtim nga organizata e hendbollit,
- Gjyqtarët, vëzhgues/kontrolluesit, si dhe punëtorë të tjerë të Hendbollit, të cilët implikohen ose ndërhyjnë direkt në mbarëvajtjen e ndeshjeve, trukime ose situata të ngajshme, do të dënohen 200 Euro gjobë, dhe deri në 2 vite diskualifikim, e në raste shumë më të rënda deri në diskualifikim të përjetshëm nga Organizata e Hendbollit.
- për shkak të imponimit në nxjerrjen e akteve të caktuara në kundërshtim me ligjet pozitive ekzistuese, të cilat e rregullojnë lëmin e hendbollit, me dënim deri në një vit, kurse me diskualifikim të përjetshëm dhe përjashtim nga organizata e hendbollit ndëshkohet kur si propozues i tyre ka ditur se ato janë në kundërshtim me ligjet pozitive,
- për shkak të kundërshtimit të politikës së përcaktuar në sport dhe kulturë fizike nga ana e organeve përkatëse të FHK, me ndalim të ushtrimit të të gjitha funksioneve në sportin e hendbollit më së paku 6 muaj deri në 1 vit, e në raste shumë më të rënda, me diskualifikim të përjetshëm dhe përjashtim nga organizatat e hendbollit,
- për shkak të refuzimit të paarsyeshëm për konvokimin e mbledhjes së organeve, trupave të organizatës së hendbollit, kryetar i së cilës është, me ndalim të ushtrimit të funksioneve në sportin e hendbollit prej 6 muajve deri në një vit,
- për shkak të regjistrimit të parregullt të lojtarit, të lëshuarit të dokumentacionit për regjistrim në bazë të dokumenteve të dyshimta apo të rreme, si dhe mbajtjes jo të saktë të librit të regjistrimit, me ndalim të të ushtruarit të të gjitha funksioneve në sportin e hendbollit së paku një vit, e në rastet e rënda, me përjashtim nga organizata e hendbollit dhe diskualifikim të përjetshëm,
- për shkak të dhënies së vërtetimit me nënshkrim apo vulë të dokumenteve të organizatës të hendbollit, të cilat janë të bazuara rrethshëm, me ndalim të ushtrimit të të gjitha funksioneve në sportin e hendbollit së paku një vit,
- për shkak të ikjes në ushtrimin e funksionit të caktuar, me vërejtje qortim apo ndalim të ushtrimit të funksionit 6 muaj.
- Për shkak të sjelljeve të cilat e fyejnë autoritetin e organizatës së hendbollit, prej 3 muajve deri në një vit ndalim të ushtrimit të funksionit,
- Për shkak të marrëdhënieve të parregullta ndaj organeve kompetente të organizatës së hendbollit, me ndalim të ushtrimit të funksionit deri një vit,
- Për shkak të moszbatimit të mendimeve, konkluzave dhe akteve të tjera përkatëse të organizatës së hendbollit, me ndalim të ushtrimit të funksionit deri në një vit.

Neni 76

Klubi i cili nuk e zbaton vendimin e plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm të organit kompetent, do të ndëshkohet me dënim në të holla në shumë deri 200 € ose me marrjen e 2 pikëve.

DISPOZITAT PROCEDURALE

Organet disiplinore:

Neni 77

1. Kundërvajtjet disiplinore të shkaktuara brenda klubit, i shqiptojnë organet disiplinore të përcaktuara me Statut dhe Rregullore disiplinore të klubit.

2. Kundërvajtjet disiplinore të shkaktuara në gara, lidhur me garat në shkallë të parë i shqyrton Komisari i garave (Komisioni), përkatësisht organi ekzekutiv i Bordit të FHK-së.
3. Kundërvajtjet disiplinore të parapara në aktet e FHK-së dhe lidhjeve komunale të hendbollit, organet kompetente të përcaktuara me këto akte.
4. Kundërvajtjet disiplinore, të cilat i kryejnë individët apo organizatat e hendbollit, lidhur me kryerjen e obligimeve nga kompetencat e FHK, Komisioni disiplinor i Bordit të FHK-së në shkallë të parë, ndërsa Këshilli i garave në shkallë të dytë.

Organet disiplinore përbëhen prej anëtarëve, apo nga Komisari i garave (Komisioni i garave) kur kemi të bëjmë me kundërvajtjet në gara. Vendimet meritore merren me praninë e shumicës së anëtarëve të Komisionit disiplinor.

Të gjitha organet disiplinore janë të obliguara të mbajnë evidencën e dënimeve të plotëfuqishme, të cilat i kanë shqiptuar.

Neni 78

I. Hapja dhe rrjedha e procedurës:

Neni 79

Ndaj askujt nuk mund të fillojë procedura disiplinore dhe askush nuk mund të dënohet, në qoftë se fletëparaqitja nuk është bërë në afatin e paraparë. Afati për paraqitjen e fletëparaqitjes disiplinore është 30 ditë nga dita e kundërvajtjes së bërë, përkatësisht konform afatit të paraparë në nenin 15 të kësaj rregulloreje.

Neni 80

Vendimet, punët dhe veprimet e procedurës disiplinore i ndërmerr dhe i miraton organi kompetent disiplinor. Disa punë dhe veprime të procedurës disiplinore, mund t'i kryejë anëtari i autorizuar i organizatës së hendbollit (vëzhgimi, shikimi i vendit të ngjarjes).

Neni 81

Kryerësi i kundërvajtjes disiplinore ka të drejtë që me shpenzime të veta të kërkojë nga organi disiplinor pjesëmarrjen në seancat e udhëhequra në të dy shkallët (shkalla I dhe II.). Organet disiplinore janë të obliguara të aprovojnë kërkesën e tij.

Neni 82

Procedura disiplinore inicohet në bazë të:

- raportit të delegatit,
- fletëparaqitjes të çdo personi, anëtar i organizatës së hendbollit, i cili e vëren kundërvajtjen disiplinore,
- fletëparaqitjes së trupave dhe organeve të hendbollit,
- fletëparaqitjes së gjyqtarit,
- fletëparaqitjes së organizatave të hendbollit, bashkësive të klubeve dhe lidhjeve të hendbollit,
- fletëparaqitjes nga ana e sekretarit të FHK-së
- fletëparaqitjes së Bordit të FHK,
- sipas detyrës zyrtare, kur organi disiplinor ka dijeni se është kryer kundërvajtja disiplinore.

Të gjitha fletëparaqitjet duhet të jenë të kompletuara dhe të argumentuara mirë.

Neni 83

Organet disiplinore janë të obliguara të kujdesen për kompetencat, afatet, parashkrimet dhe shqiptimet e dënimeve.

Neni 84

Konfliktin e kompetencave të organeve disiplinore e zgjidh organi i parë më i lartë disiplinor, i cili ka shtrirje më të gjerë të organizimit territorial.

Neni 85

Pas marrjes të fletëparaqitjes, organi disiplinor menjëherë e fillon procedura, e më së largu 8 ditë pas marrjes së saj, përkatësisht marrjes në dijeni për kundërvajtjen e shkaktuar. Kur organi disiplinor e fillon procedurën, ai e fton të pandehurin për dhënien e deklaratës dhe për ta marrë në pyetje.

Neni 86

Procedura disiplinore është urgjente, në shkallë të parë duhet të përfundojë në afat prej 15 ditësh nga dita e inicimit.

Procedura disiplinore në shkallë të dytë duhet të përfundojë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së ankesës.

Organi disiplinor i shkallës së parë është i obliguar që në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së ankesës, ta kompletojë lëndën e procedurës së shkallës së parë dhe atë t'ia përcjellë organit disiplinor të shkallës së dytë në kompetencë të mëtejme.

Neni 87

Në rastet kur nuk veprohet sipas afateve të parapara, kryetari dhe anëtarët e organit disiplinor do të përgjigjen për shkelje të bëra, të parapara me nenin 76 të kësaj rregulloreje.

Neni 88

Përgjegjësia e anëtarit të organizatës së hendbollit për veprat penale, kundërvajtje disiplinore konform dispozitave të kësaj rregulloreje.

SUSPENDIMI:

Neni 89

Në qoftë se organi disiplinor vërteton se nuk ka vend për hapjen e procedurës disiplinore, me vendim e refuzon fletëparaqitjen e ushtruar. Në qoftë se procedura disiplinore është e hapur, ndërkohë paraqiten fakte të cilat tregojnë se nuk ka vend për procedurë, organi disiplinor e pezullon atë. Ndaj këtyre vendimeve të organeve disiplinore, ushtruesi i fletëparaqitjes ka të drejtë ankese komisionit të shkallës së dytë.

Neni 90

Në qoftë se gjatë procedurës disiplinore janë shkaktuar shpenzime, atëherë organi i cili ka udhëhequr procedurën, do të vendosë për subjektet e përmbushjes së tyre. Shpenzimet e shkaktuara nga ana e klubit apo anëtarit të klubit të cilit i shqiptohet dënimi, bien në barrën e buxhetit të klubit.

Në qoftë se klubi apo anëtari i klubit, ndaj të cilit është hapur procedura, lirohet nga përgjegjësia, shpenzimet bien në barrën e buxhetit të organit i cili e ka udhëhequr procedurën.

Neni 91

Organi disiplinor mund të marrë vendim për suspendimin e individit apo organizatës së hendbollit, në raste kur është paraparë dënimi kohor ose dënimi më i rëndë, varësisht nga pesha dhe kushtet e kryerjes së kundërvajtjes disiplinore. Vendimi mbi suspendimin shpallet në buletin zyrtar ose përpilohet në formë të shkruar dhe i përcillet të suspenduarit.

Neni 92

Koha e suspendimit llogaritet në dënim.

Neni 93

Deri në përfundimin e procedurës disiplinore, suspendimi mund të zgjasë më së shumti 3 muaj. Organi i shkallës së parë është i autorizuar ta ndërprerje suspendimin para përfundimit të procedurës, në qoftë se kanë pushuar arsyet e caktimit të tij. Organi i shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës, mund ta ndërpresë suspendimin më heret.

Neni 94

Përfundimisht nga dispozitat e nenit 91 paragrafi i kësaj rregulloreje, suspendimi mund të zgjatet më shumë se 3 muaj, nëse nga organet kompetente ka filluar procedura penale ose procedura administrative ndëshkuese kundër anëtarëve të organizatës së hendbollit. Personi i tillë mund të suspendohet deri në përfundimin e kësaj procedure.

Neni 95

Suspendimi për individë (lojtarë, persona zyrtarë, gjyqtarë, punëtorë sportivë të hendbollit) organe e organizata të hendbollit, të cilët kanë obligime ndaj organeve gjegjëse, të cilat e udhëheqin të parapara ndaj organeve të përmendura.

SHQIPTIMI I DËNIMEVE

Neni 96

Për marrjen e vendimeve të plotfuqishme të kundërvajtjeve disiplinore, është e obliguar që në mbledhjet e organeve kompetente disiplinore të marrin pjesë shumica e anëtarëve të organeve gjegjëse. Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të organeve të cilat u udhëheqin procedurën. Në rast të votimit të barabartë të anëtarëve të pranishëm, vendos vota e kryetarit të organit kompetent kur kemi Komisionit të garave, etj).

Neni 97

Kundërvajtjet disiplinore dhe suspendimet, të cilat i shqiptojnë organet kompetente disiplinore lidhur me shkeljen e dispozitave të garave, publikohen në buletin zyrtar të organeve të garave.

Në të gjitha rastet e tjera vendimet mbi dënimet përpilohen dhe ato duhen të përmbajnë:

- hyrjen
- dispozitivin,
- arsyetimin dhe
- këshillën për mjetin juridik.
- Hyrja përfshin emrin dhe përbërjen e organit disiplinor, bazën juridike kompetencë, kohën dhe vendin e marrjes së vendimit.

Dispozitivi përfshin të dhënat e kryerësit të kundërvajtjes disiplinore, përshkrimin, llojin e kundërvajtjes, marrësin e dispozitave sipas të cilit është marrë vendimi, lloji dhe lartësia e dënimit, kohën prej kur fillon të llogaritet dënimi dhe vendimi për suspendim.

Arsyetimi duhet të përfshijë afatin gjatë të cilit duhet të ushtrohet ankesa, si dhe mënyrën dhe organin të cilit i dorëzohet.

Këshilla juridike jepet vetëm me mjete të rregullta juridike.

Neni 98

Vendimet e organeve disiplinore, palëve iu dorëzohen personalisht apo me letra postale rekomande si dhe përmes e-mailit post elektronike . Kur vendimi për dënim publikohet në buletin zyrtar të organeve të garave, organi i disiplinor është i obliguar që dorëzimin e tij t'iu bëjë të gjithë të dënuarve personalisht apo me letër rekomande postale.

Neni 99

Nga një kopje të vendimit mbi dënimet e shqiptuara për persona fizikë, organi disiplinor është i obliguar t'ia dorëzojë njëkohësisht organizatës së hendbollit, anëtar i së cilës është personi i ndëshkuar. Në qoftë se organi disiplinor nuk e ka adresën e saktë të personit fizik, dorëzimi i vendimit mund të bëhet përmes ekipit, përkatësisht organizatës së hendbollit, anëtar i së cilës është personi. Në rast të refuzimit të marrjes të vendimit, konsiderohet se është bërë dorëzimi. Refuzimi mbi marrjen e vendimit duhet të argumentohet.

MJETET JURIDIKE:

Neni 100

Kundër vendimit të organit të shkallës së parë, mund të paraqitet ankesa në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së tij. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e dënimit. Ankesa i paraqitet organit të shkallës së dytë përmes organit disiplinor të shkallës së parë, me dorëzim personal apo me anë të postës në mënyrë rekomande. Afat i dorëzimit të ankesës merret koha kur personalisht i është dorëzuar organit të shkallës së parë, ose koha kur është dorëzuar në postë në letër rekomande (data me vulë postale) apo data e e-mailit nëse është dërguar me post elektronike.

Neni 101

Kundër vendimit për suspendim mund t'i paraqitet ankesë organit të shkallës së dytë, sikurse është paraparë në nenin paraprak të kësaj rregulloreje, në afat prej 3 ditësh, nga dita e marrjes së vendimit mbi suspendim. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit për suspendim.

A. Procedura sipas ankesës

Neni 102

Pas marrjes së ankesës, organi i shkallës së parë është i obliguar që në afatin prej 8 ditësh, atë ta kompletojë me të gjitha shkresat e parashtruara dhe së bashku me mendimin e vet, t'ia përcjellë organit të shkallës së dytë në kompetencë të mëtejme. Procedura e shkallës së dytë duhet të përfundojë në afat prej 30 ditësh prej ditës marrjes së ankesës.

Neni 103

Organi i shkallës së dytë, duke vendosur sipas ankesës mund:

- ankesën ta hedhë si të ushtruar pas afatit të paraparë, apo nga personi i paaautorizuar,
- ankesën ta refuzojë dhe vendimin e organit të shkallës së parë ta vërtetojë,
- ankesën ta aprovojë dhe lëndën t'ia kthejë organit të shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, dhe
- ankesën ta aprovojë, ndërsa vendimin e organit të shkallës së parë ta ndryshojë.

Neni 104

Nëse ankesa është ushtruar vetëm në dobi të dënuarit, në procedurën e mëtejme kundër tij nuk mund të shqiptohet dënimi më i rëndë.

Neni 105

Vendimi i shkallës së dytë është përfundimtar.

Mjetet e jashtëzakonshme juridike:

Neni 106

Mjetet e jashtëzakonshme juridike konform dispozitave të kësaj rregulloreje janë:

- kërkesa për përsëritjen e procedurës dhe
- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Neni 107

Përsëritja e procedurës mund të kërkohej në rast se gjatë udhëheqjes së procedurës paraprake, dukshëm janë shkelur dispozitat materiale të procedurës apo nëse ekzistojnë prova dhe fakte të reja, të cilat janë qenësore në marrjen e vendimit, e të cilat më parë nuk kanë qenë të njohura.

Neni 108

Kërkesa për përsëritjen e procedurës mund të paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dijeni për faktet dhe provat e reja, përkatësisht nga dita e konfirmimit të shkeljes qenësore të dispozitave të procedurës.

Neni 109

Kërkesa për përsëritjen e procedurës i paraqitet organit disiplinor, i cili ka marrë vendim në shkallën e parë.

Për propozim vendos organi më i lartë disiplinor, të cilit organi i shkallës së parë ia përcjell propozimin me të gjitha shkresat e lëndës. Organi më i lartë disiplinor për garat e FHK-së, është Komisioni disiplinor i FHK. Për përsëritjen e procedurës vendos i njëjti organ.

Neni 110

Organi kompetent, kërkesën për përsëritjen e procedurës, mund ta hedhë, ta refuzojë, ta aprovojë dhe vetë të udhëheqë procedurë të re ose ta aprovojë dhe kërkesën t'ia kthejë organit të shkallës së parë në ri procedurë dhe rivendosje.

Neni 111

Kërkesën për përsëritjen e procedurës mund ta paraqesë personi i dënuar, organizata e hendbollit ose paraqitësi i fletëparaqitjes.

Neni 112

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet nëse janë bërë shkelje qenësore dhe të rënda të dispozitave të kësaj rregulloreje, apo akteve të tjera të përgjithshme të FHK, në të cilat paraqiten shkelje disiplinore dhe procedurat. Sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë do të veprohet konform dispozitave të parapara me Statutin e FHK.

Neni 113

Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, konform dispozitave të kësaj rregulloreje, mund ta paraqesin:

- Këshilli mbikëqyrës i Federatës.
- Anëtari i interesuar, organizata e hendbollit ose klubi.

Neni 114

Mbi kërkesën e mbrojtjes së ligjshmërisë vendos:

Bordi i FHK në raste të kompetencave të organeve disiplinore të ligave të garave.

Kryesia e Lidhjeve komunale të hendbollit, në rastet e kompetencave të organeve disiplinore të garave komunale.

Neni 115

Bordi kompetent, kërkesën mund ta hedhë, ta refuzojë, ta aprovojë dhe vetë të marrë vendim apo ta aprovojë dhe lëndën t'ia kthejë organit të shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Neni 116

Në rast të konfliktit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe përsëritjen e procedurës, kompetente për zgjidhjen e tij është Bordi i FHK-së.

LEHTËSIMI I JASHTËZAKONSHËM I DËNIMIT

Neni 117

Kur ekzistojnë prova të pakontestueshme se dënimi i shqiptuar, i cili është i ekzekutuar, e ka arritur qëllimin e vet në të gjitha aspektet e parapara edukativo-sportive, Bordi i FHK-së dhe kryetari i Bordit në raste të caktuara,

në jubiletë dhe festat shtetërore mund të lehtësojnë dënimet. Po ashtu lehtësimin e dënimit mund ta bëjë edhe Kuvendi i FHK-së nëse më parë Bordi i FHK-së ka refuzuar kërkesën për lehtësim të të ndëshkuarit. Lutjen si në rastin e parë edhe në rastin e dytë për uljen e jashtëzakonshme të dënimit, mund ta dorëzojë personi i dënuar, organizata e hendbollit apo klubi, anëtar i të cilit është i dënuari, dhe këtë së paku 8 ditë para seancës së caktuar të Kuvendit gjegjë.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 118

Në qoftë se lojtari është i dënuar me ndalesë loje për numër të caktuar të ndeshjeve, dënimi i shqiptuar konform dispozitave të kësaj rregulloreje, nënkupton ndeshjet kampionale dhe të Kupës të organizura nga organet kompetente të FHK, si dhe ndeshjet e tjera të paraqitura në programin e FHK-së.

Neni 119

Procedura disiplinore para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të përfundojë sipas dispozitave të rregullores paraprake, në qoftë se ato janë më të favoshme për kryesinë e kundërvajtjes.

Neni 120

Bordi i FHK është e autorizuar të japë interpretime autentike të dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 121

Në Propozicionet e garave mund të parashihen dënime më të lehta, por jo më të më të rënda nga të përcaktuarat me këtë rregullore, si dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike dhe kompetencat e organeve për vendosjen e tyre. Nëse me Propozicione janë paraparë masa dhe ndëshkime në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, do të aplikohen dispozitat e kësaj rregulloreje, përkatësisht dispozitat më të favorshme për palën.

Neni 122

Kjo rregullore është aprovuar në mbledhjen e Bordit të FHK-së të mbajtur me datë 04.09.2014 dhe hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit (aprovimit) të saj.

BORDI I FHK-së
Eugen Saraçini d.v.
President